

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

C.nr.147/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit:
kundër të paditurit nga fshati
Mitrovicës, baza e kontestit Kompensim dëmi, pas mbajtjes se seancës kryesore me datë 05.06.2017 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. OBLIGOHET** i padituri nga Fshati Komuna e Mitrovicës që brenda afatit 7 ditorë në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga prerja ilegale e drunjëve- vepër kundërvajtëse në sasi prej 3.10 m³, t'ia paguaj paditëses shumën prej 474.30 €, me kamat sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar; nga data e parashtrimit të padisë e gjer në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II. OBLIGOHET** i padituri që në emër të shpenzimeve për përpilim të aktgjykimit t'ia paguaj gjykatës shumën paditëses shumën prej 15 €, , në afat 7 ditorë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi ka ngritur padi në gjykatë me datë 16.03.2015, me anë të së cilës ka kërkuar që në emër të kompensimit të dëmit, i padituri t'ia kompensoj shumën prej 474.30 € që rrjedh nga vjedhja e pyllit.

I autorizuari i paditësit në seancë e shqyrtimit kryesor të datës 25.04.2017, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

I padituri në seancë deklaroi se e kundërshton kërkesëpadinë e paditëses pasi që drunjtë i kam prerë në malin tim dhe unë në vazhdimësi e edhe më tutje merrem me këtë çështje në mungesë të ndonjë burimi tjetër financiar duhet që të mbetem gjalëe nga shitja e drunjëve, mirëpo çdoherë drunjtë i kam prepë në malin tim dhe me leje të organeve përkatëse. Përveq që është mbajtës i familjes dhjetë anëtarëshe, i njëjti është kujdestar i familjes së vëllaut të ndjerë, të tre jetimëve dhe kumatës. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit në mënyrë të drejt dhe të plot të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje kontestuese nxorri dhe administroi këto prova: Aktvendimi K.nr.5050/14, kërkesa e dt.07.04.2014, shkresa e Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve e dt.07.04.2014, kopja e letërnjoftimit të të paditurit, fletat përcjellëse lëshuar nga Agjensia Pyjore e Kosovës të datave 28.09.2014, 21.10.2014, 04.11.2014, 02.12.2014.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 I LPK-së (Ligjit të Procedurës Kontestimore), arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga Aktvendimi i kundërvajtjes K.nr.5050/14, kërkesa e dt.07.04.2014, në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet fakti se i padituri me dt.31.03.2014 në vendin e quajtur Te Tregu-Mitrovicë është zënë me masë drunore të llojit Ahu të gjata_m dhe me diametër 12-25 cm me vëllim të përgjithshëm prej 3.10 m³, për të cilat drunjtë i padituri nuk ka pasur dokument valid- leje për prerje.

Se i padituri është zënë me masë drunore në vendin e cekur si në paragrafin më lartë, këtë fakt e ka konstatuar punëtori i autorizuar i P-se me anë të procesverbalit gjegjësisht raportit.

Për shkak të sasisë së vogël pala nuk është ndjekur në procedurë penale por ka shkuar në procedurë civile.

Në raport me shumën e dëmit që i është shkaktuar paditëses me veprimin e të paditurit, gjykata të njëjtin e bazoi në bazë të Udhëzimit Administrativ MA-NR.12/2005 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës dhe atë nga tabela e çmimeve për kompensimin e dëmit pyjorë ma saktësisht nr 3 i kësaj tablele ku parasheh, çmimi i kompensimit për m³ është 153 €, ku dëmi i shkaktuar nga i padituri është 3.10 m³ e kur e shumëzojmë me 153 është i barabartë me 474.30 € (153X3.10=474.30), andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke u bazuar në parimin e ekonomizimit të procedurës vlerësoi faktin se për rastin konkret nuk është e nevojshme të caktohet ekspert për

Ilogaritje të dëmit pasi që vetëm do të rriteshin shpenzimet procedurale gjyqësore sepse llogaritja sipas udhëzimit administrativ 12/2005 është shumë e thjeshtë dhe e lehtë.

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar konform dispozitave ligjore të LMD-së (i vjetri i aplikuar në këtë rast), ma saktësisht neni 158 në lidhje me nenin 185 par 1,2 dhe 4.

Lidhur me kamatë, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 277 par 1 të Ligjit të vjetër të Marrëdhënieve të Detyrimeve, ndërsa lidhur me lartësinë e sajë, u bazua në lartësinë e mjeteve të deponuara në banka afariste për një vit pa destinim të caktuar.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 450 të LPK-së, meqenëse pala paditëse si fituese e kontestit nuk i kërkoi shpenzimet, gjykata vendosi që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale, ndërsa gjykatës shpenzimet për përpilim të aktgjykimit duhet t'ia paguaj pala e paditur.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë dhënë arsye të mjaftueshme për të vërtetuar faktet vendimtare të cilat shpijnë drejtë aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit.

Andaj gjykata nga të lartë cekurat, e në bazë të nenit 143 të LPK-së (Ligjit të Procedurës Kontestimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.147/2015. dt.05.06.2017

GJYQTARI
Faton Ademi



UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.